



## Udhëzimi 4

Shtator 2016

### Prokurimi publik

# Kontratat e mbuluara nga Direktivat e Prokurimit Publik

#### PËRMBAJTJA

- [Konteksti i përgjithshëm: Llojet e kontratës, karakteristikat e përbashkëta](#)
- [Kontrata e punëve, kontrata e furnizimeve dhe kontrata e shërbimeve](#)
- [Klasifikimi i kontratave](#)
- [Përjashtimet](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s

## Konteksti i përgjithshëm: Llojet e kontratave, karakteristikat e përbashkëta

**Llojet e kontratës:** Direktiva e Sektorit Publik<sup>1</sup> e përcakton prokurimin si "blerjen me anë të një kontrate publike të punëve, furnizimeve ose shërbimeve nga një ose më shumë autoritete kontraktore nga operatorët ekonomik të zgjedhur nga këto autoritete kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet apo shërbimet janë të destinuara janë apo jo për qëllime publike". Përkufizimi në Direktivën e Shërbimeve<sup>2</sup> është praktikisht i njëjtë.

Direktivat<sup>3</sup> mbulojnë tri lloje kryesore kontratash: punët, furnizimet dhe shërbimet, duke përfshirë edhe konkurset e projektimit.

Kontratat shpesh do të përmbajë elemente të një ose më shumë prej llojeve të mësipërme të kontratës. Kështu një kontratë për të ndërtuar një ndërtesë mund të përfshijë shërbime të projektimit dhe furnizime të caktuara të nevojshme. Në mënyrë të ngjashme, një kontratë furnizimi mund të përfshijë shërbimet e vendosjes dhe të instalimit. Direktivat përmbajnë rregulla të veçanta të cilat përdoren për t'i klasifikuar këto si "kontrata të përziera."

Një numër kontratash përjashtohen plotësisht nga fusha e zbatimit të Direktivave (por jo domosdoshmërisht nga Traktati),<sup>4</sup> ose për shkak të natyrës së tyre, që do të thotë se do të ishte e papërshtatshme të zbatoheshin dispozitat e direktivave, ose për shkak se ato janë subjekt i sistemeve të ndryshme të rregullimit ose administrimit. Disa kontrata, "kontratat e rezervuara të reja" marrin trajtim të veçantë si rezultat i identitetit të atyre që furnizojë mallrat apo që realizojnë punët dhe ofrojnë shërbimet.

Edhe nëse kontratat nuk janë të përjashtuara, ato do të jenë subjekt i dispozitave të Direktivave vetëm nëse vlera e tyre e tejkalon vlerën përkatëse monetare të përcaktuar në Direktiva - kufirin financiar të BE-së. Këto kufizime pasqyrojnë nivelin në të cilin Ligjvënësi i BE-së ka supozuar se është e mundur tregtia ndërkufitare (megjithëse është e mundur që, në varësi të rrethanave, ofertuesit mund të jenë të interesuar në kontratat nën kufirin financiar në Shtete të tjera Anëtare të BE-së – duhet mbajtur parasysh se për dhënien e këtyre kontratave zbatohen parimet e përgjithshme në çdo rast). Me qëllim të parandalimit të metodave krijuese të llogaritjes së vlerës së kontratave që do të jepen, Direktivat parashikojnë rregullat dhe metodat e llogaritjes dhe ndalojnë metodat e projektuara për të anashkaluar Direktivat duke ndarë, bashkuar apo paketuar së bashku kontratat në mënyrë të tillë që kontratat të mos bëhen subjekt i dispozitave përkatëse. Për më shumë diskutim për këtë çështje, shih Udhëzimin nr. 5 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Të kuptuarit e kufijve monetarë të BE-së*.

Një dallim i rëndësishëm i bërë nga Direktivat është ai midis "kontratave" dhe "koncesioneve", ku kjo e fundit trajtohet ndryshe nga kontrata. Direktiva e veçantë, që është Direktiva e Koncesioneve, mbulon koncesionet e punëve dhe shërbimet e një vlere të caktuar.<sup>5</sup> Për më shumë diskutim për çështjen e koncesioneve, shih Udhëzimin nr. 18 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Koncesionet dhe PPP-të*, dhe Udhëzimin nr. 31 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Direktivat 2014 të BE-së: Koncesionet*.

<sup>1</sup> Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/EC, 26 shkurt 2014.

<sup>2</sup> Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorët e shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014 (Direktiva e Shërbimeve).

<sup>3</sup> Në këtë Udhëzim të SIGMA-s për Prokurimin Publik, termi "Direktivat" përdoret për t'iu referuar Direktivës së Sektorit Publik dhe Direktivës së Shërbimeve.

<sup>4</sup> Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian - version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, *Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian* C 326, 26 tetor 2012. Në Udhëzimin për Prokurimin Publik është quajtur "TFBE" ose "Traktati".

<sup>5</sup> Direktiva 2014/23/BE për dhënien e kontratave të koncesionit, 26 shkurt 2014..

**Karakteristikat e përbashkëta:** Ka disa karakteristika të përgjithshme që janë të përbashkëta për të gjitha llojet e kontratave që mbulojnë nga Direktivat.

Direktivat zbatohen për kontratat me shpërbim të lidhura me shkrim ndërmjet një operatori ekonomik dhe një subjekti kontraktor, si më poshtë:

- Kontrata duhet të lidhet për shpërbim në para, d.m.th., për para apo vlerë monetare. Duhet të ketë një shkak financiar, pa marrë parasysh se si paguhet.
- Kontrata duhet të hartohet me shkrim. Në rast se ndodh që kontrata, e cila është subjekt i Direktivave, nuk është me shkrim, atëherë ajo do të jetë subjekt i zbatimit të përgjithshëm të rregullave që përmbahen në Traktat.
- Kontrata duhet të lidhet midis dy palëve: operatori ekonomik dhe autoriteti kontraktor.

### **Kur lind një kontratë?**

Kur shpallet fituese një kontratë e re zakonisht ka pak vështirësi në identifikimin e saj. Megjithatë, ndonjëherë, identifikimi i saj nuk është i qartë. Për shembull, një kontratë ekzistuese mund të ndryshohet apo të rinovohet. Një kontratë mund të ndryshohet gjatë realizimit të saj. Të gjitha këto situata çojnë në krijimin e detyrimeve të reja midis palëve dhe mund të ndryshojnë kushtet e kontratës fillestare.

Nëse rezultati i ndryshimeve është aq i gjerë sa që kontrata e rinovuar ose e ndryshuar është krejtësisht e ndryshme nga kontrata fillestare, atëherë mund të ndodhë që do të krijohet një kontratë të re. Nëse krijohet një kontratë të re dhe të gjitha elementet e një kontrate janë të pranishme, atëherë kontrata duhet të jetë subjekt i rregullave të prokurimit, d.m.th., ajo duhet të jepet në përputhje me dispozitat e Direktivave. Kjo kërkesë nënkupton se një zgjerim, rinovim apo ndryshim i thjeshtë mund të mos lejohet në qoftë se ai është bërë pa konkurrim. Për më shumë diskutim për çështjen e modifikimeve të kontratës, shih Udhëzimin nr. 38 të SIGMA-s për Prokurimin Publik 38, *Modifikimet e kontratës*.

### **Kontrata e punëve krahasuar me kontratën e mallrave dhe me kontratën e shërbimeve**

**Çfarë është kontrata e punëve?** Kontratat e punëve janë përkufizuar si ato kontrata që kanë si objekt:

- Ose vetëm realizimin ose projektimin dhe realizimin e punimeve në lidhje me një nga aktivitetet e referuara në Aneksin II të Direktivës (Aneksi I i Direktivës Shërbimeve);
- Realizimin, ose të dyja, projektimin dhe realizimin e një pune;
- Realizimin, me çfarëdo mënyre, i një pune që korrespondon me kërkesat e specifikuar nga subjekti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektimin e punës.

Mundësia e përfshirjes së punëve të projektimit në një kontratë të punëve do të thotë se kontratat "projekto dhe ndërto" mund të klasifikohen nën përkufizimin e një kontrate të punëve. Ky përkufizim mund të përfshijë, për shembull, kontratat që mbulojnë planifikimin dhe financimin e një projekti, si dhe realizimin e tij. Kur projektimi dhe ndërtimi jepen veç e veç, atëherë shërbimi i projektimit do të jetë një shërbim që mbullohet nga rregullat e prokurimit publik lidhur me shërbimet ose, përndryshe, mund të jepen me anë të një konkursi të projektimit.

Për pjesën e dytë të përkufizimit, "puna" është rezultati i ndërtimit ose i punëve inxhinierike të marra në tërësi që është i mjaftueshëm në vetvete për të përmbushur një funksion ekonomik dhe teknik. Ky përkufizim është i rëndësishëm për një numër arsyesh, veçanërisht në kontekstin e realizimit të punimeve me çdo mjet dhe për qëllimet e vlerësimit të vlerave të kufirit monetar dhe, rrjedhimisht, kur vendoset nëse një kërkesë e vetme për punë është ndarë apo jo me qëllim që kontratat të bien nën vlerën përkatëse të kufirit monetar.

**Çfarë është kontrata e furnizimeve?** Përkufizimi i furnizimeve është më i thjeshtë se ai punëve ose shërbimeve. "Kontratat e furnizimit publik" përkufizohen si kontratat që kanë objekt blerjen, lizingun, qiranë ose pagimin me këste gjatë përdorimit, me ose pa opsionin e blerjes së produkteve. Përveç kësaj, ofrimi i produkteve të tilla mund të përfshijë operacionet e vendosjes dhe të instalimit.

Gama e produkteve që mbulohen nga Direktivat mund të shihet në nomenklaturat e ndryshme të përdorura për të përshkruar produktet për qëllimet e reklamimit. Shih, për shembull, Fjalorin e Përbashkët i Prokurimit (FPP).

**Çfarë është kontrata e shërbimeve?** Termi "kontratë shërbimesh" në thelb i referohet një kontrate të ofrimit të shërbimeve që është e ndryshme nga kontrata e punëve. Një numër shërbimesh janë të përjashtuara në mënyrë specifike, kryesisht për shkak se ato nuk janë të përshtatshme për t'u blerë, sipas rregullave të parashikuara nga Direktivat. Dhënia e shërbimeve të tjera rregullohet nga Direktivat, megjithëse në një masë më të vogël ("regjimi i lehtë").

**Kontratat e shërbimeve – regjimi i lehtë:** Direktivat kanë hequr dallimin midis shërbimeve parësore dhe jo-parësore, siç parashikohet në direktivat e prokurimit të vitit 2004.<sup>6</sup> Si rezultat i kësaj, zbatimi i plotë i Direktivave është zgjeruar ndaj disa shërbimeve. Megjithatë, disa kategori të shërbimeve dhe, konkretisht, shërbimet e referuara si "shërbime për personin", të tilla si shërbimet e veçanta sociale, shëndetësore dhe arsimore janë dhënë në një kontekst të veçantë, i cili ndryshon ndërmjet shteteve anëtare për shkak të traditave të tyre të ndryshme kulturore, ndërkohë që nga vetë natyra e tyre ato kanë një dimension të kufizuar ndërkufitar. Për këtë arsye, në Direktivat për dhënien e kontratave të shërbimeve të tilla është krijuar një regjim i veçantë i lehtë, me pragun prej 750 000 Eurove (1 000 000 Eurove në rastin e shërbimeve), i cili është shumë më i lartë se pragu që vlen për shërbimet e mbuluara plotësisht.

Shërbimet e rregulluara në këtë mënyrë janë të listuara në Aneksin XIV të Direktivës dhe në Aneksin XVII të Direktivave të Shërbimeve.

Lista e këtyre shërbimeve përfshin, për shembull,:

- Shërbimet shëndetësore, sociale dhe shërbimet e lidhura;
- Shërbimet administrative, arsimore, sociale, të kujdesit shëndetësor dhe ato kulturore;
- Shërbimet e sigurimeve të detyrueshme shoqërore;
- Shërbimet e hotelit dhe të restorantit;
- Shërbimet ligjore, deri në masën që ato nuk janë të përjashtuara krejtësisht nga Direktivat;
- Shërbimet e hetimit dhe të sigurisë;
- Shërbimet ndërkombëtare;
- Shërbimet postare.

Këto shërbime janë të listuara në anekset me kodet e tyre përkatëse të FPP-së (Fjalori i Përbashkët i Prokurimit).

Mënyra sipas së cilës duhet të prokurohen shërbimet regjimit të lehtë nuk është e rregulluar në Direktiva. Shteteve anëtare u është dhënë diskrecion i gjerë për organizimin e procedurave të prokurimit, me kusht që të respektohen rregullat e përgjithshme të përcaktuara në nenet 74 deri 76

<sup>6</sup> Direktiva 2004/18/KE mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimit publik, 31 Mars 2004, dhe Direktiva 2004/17/KE mbi koordinimin e procedurave të prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin e ujit, të energjisë, transportit dhe në sektorë e shërbimeve postare, 31 mars 2004.

të Direktivës (nenet 92 dhe 93 të Direktivës së Shërbimeve). Këto rregulla të përgjithshme janë si më poshtë:

- Kontratat me vlerë të barabartë ose mbi pragjet e lartpërmendura duhet të shpallen në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE)*, ose në formën e njoftimit të kontratës ose në formën e Njoftimit të zgjeruar Paraprak të Informimit.
- Rregullat duhet t'i lejojë autoritetet kontraktore që të marrin në konsideratë specifikat e shërbimit në fjalë.
- Njoftimi i dhënies së kontratës duhet të publikohet në *GZBE*; megjithatë, autoritetet kontraktore mund t'i grupojnë së bashku njoftimet që lidhen me këto shërbime dhe t'i publikojnë ato në baza tremujore.
- Rregullat duhet të sigurojnë që autoritetet kontraktore marrin parasysh nevojën për të siguruar cilësinë, vazhdimësinë, aksesin, përballueshmërinë, disponueshmërinë dhe tërësinë e shërbimit, si dhe nevojat e veçanta të kategorive të ndryshme të përdoruesve të shërbimit.

### Klasifikimi i kontratës

**Si klasifikohet një kontratë kur ajo përfshin përzjerje të elementeve të ndryshme?** Kontratat duhet të klasifikohet si kontrata të punëve, shërbimeve ose e furnizimeve për shkak se dispozita të ndryshme të Direktivave zbatohen për llojet e ndryshme të kontratës. Problemet mund të lindin kur përcaktohet se si duhet të klasifikohet një kontratë siç kërkohet kur kontrata është një kombinim i punëve dhe/ose furnizimeve dhe/ose shërbimeve. Direktivat përmbajnë dispozita se si është trajtuar ky problem, për shembull:

**Shërbimeve plotësisht të rregulluara dhe shërbimet e mbuluara nga kontratat e shërbimeve regjimit të lehtë - testi i vlerës:** Direktivat zbatojnë një test vlere të qartë për kontratat e shërbimeve që përmbajnë të dy llojet e shërbimeve. Kontratat duhet të jenë kontrata për shërbimet plotësisht të rregulluara nëse vlera e këtyre shërbimeve është më e madhe se vlera e shërbimeve të mbuluara nga regjimi i lehtë. Kontratat duhet të mbulohet nga regjimi i lehtë, nëse vlera e shërbimeve pjesërisht të rregulluara është më e madhe se vlera e shërbimeve plotësisht të mbuluara.

**Furnizimet/shërbimet – test i vlerës:** Në thelb, kontratat që përmbajnë elemente të të dy furnizimeve dhe shërbimeve duhet të trajtohen si njëri lloj apo lloji tjetër i kontratës në varësi të vlerës së përfaqësuar nga çdo element.

Kontrata duhet të konsiderohet si kontratë shërbimesh nëse vlera e shërbimeve të kryera është më e madhe se vlera e produkteve të ofruara. Ku vlera është e barabartë, atëherë kontrata duhet të jepet në përputhje me dispozitat e aplikueshme ndaj llojit të prokurimit që karakterizon subjektin kryesor të kontratës në fjalë. Përkufizimi nuk bën asnjë dallim në mes të shërbimeve plotësisht të rregulluara dhe shërbimeve të regjimit të lehtë, me qëllim që kur vlera e shërbimeve jo parësore të një kontrate të përzjer është më e madhe se vlera e furnizimeve, atëherë e gjithë kontrata duhet të trajtohet si një kontratë shërbimesh e regjimit të lehtë.

**Punët/shërbimet – testi i objektit kryesor:** Në rastin e punëve dhe shërbimeve, Direktivat nuk japin ndonjë test të vlerës, por përfshijnë një test të bazuar në objektin kryesor të kontratës.

**Punët/furnizimet:** Në bazë të Direktivave, kontratat e furnizimeve që po ashtu mbulojnë, si çështje dytësore, operacionet e vendosjes dhe të instalimit përkufizohen si kontrata të furnizimeve. Për shembull, në rastin e blerjes së një vinçi që do të instalohet në një dok, objekti i kontratës është sjellja e vinçit dhe jo punët e nevojshme për vendosjen e atij, edhe në qoftë se ato janë punë të konsiderueshme.

Testi i "objektit kryesor", i cili pasqyron mënyrën sipas të cilës dallohen kontratat e punëve dhe të shërbimeve, mund të aplikohet edhe në qoftë se vlera e shërbimeve të vendosjes ose të instalimit është më e madhe se vlera e vetë furnizimeve, pasi ai është një testi i bazuar në objektin e kontratës dhe jo në testin e bazuar tek vlera që është aplikuar për të bërë dallimin në mes të mallrave dhe shërbimeve.

Direktivat gjithashtu kanë dispozita që kanë të bëjnë me kontratat e përziera, duke përfshirë atë se ku klasifikohen potencialisht kontratat nën më shumë se një regjim (sektori publik dhe koncesionet ose sektorin publik dhe shërbimet). Në rastin e një kontrate të përzier që përmban elementet e kontratave të mallrave, punëve dhe të shërbimeve, dhe koncesionet, atëherë kontrata e përzier duhet të jepet në përputhje me dispozitat e Direktivës në qoftë se një pjesë e kontratës së përzier, e cila përbën një kontratë të mbuluar nga Direktiva, është e barabartë me ose më e madhe se sa kufirin monetar përkatës të zbatimit të Direktivës.

Për kontratat, të cilat kanë si subjektin e tyre kryesor prokurimin e mbuluar nga Direktiva si dhe prokurimin e një aktiviteti që i nënshtrohet Direktivës së Shërbimeve, zbatohen rregullat e mëposhtme, dhe në qoftë se pjesë të ndryshme të një kontratë të caktuar janë *objektivisht të ndashme*, atëherë subjektet kontraktore mund të zgjedhin një nga dy opsionet e mëposhtme:

- Të japin kontratat të veçanta për pjesë të veçanta, ose
- Të japin një kontratë të vetme.

Për opsionin e parë, vendimi se cili regjim ligjor zbatohet për secilën prej kontratave të veçanta duhet të merret në bazë të karakteristikave të pjesës së veçantë në fjalë. Për opsionin tjetër, nëse subjekti kontraktor zgjedh të japë një kontratë të vetme, atëherë zbatohet Direktiva e Shërbimeve për kontratën e përzier pasuese, pavarësisht nga vlera e pjesëve që në rrethana të tjera do të klasifikoheshin nën një regjim tjetër juridik dhe pavarësisht se cilit regjim ligjor do t'i ishin nënshtruar këto pjesë në rrethana të tjera.

Në rastin kur pjesët e ndryshme të një kontratë të caktuar janë *objektivisht të pandashme*, atëherë regjimi ligjor i zbatueshëm përcaktohet në bazë të objektit kryesor e kësaj kontrate.

### A ka lloje të tjera të kontratave që i nënshtrohen Direktivave?

**Kontratat e subvencionuara:** Direktiva vlen edhe për kontratat e subvencionuara të punëve dhe kontratat e subvencionuara shërbimeve. Direktiva i mbulon këto kontrata vetëm nëse ato janë të subvencionuara direkt nga autoriteti kontraktor dhe nëse vlera e tyre tejkalon kufijtë e Direktivës që zbatohen për punët dhe shërbimet, respektivisht. Përveç kësaj, punët e subvencionuara mbulohen vetëm nëse ato kanë të bëjnë me aktivitete të inxhinierisë së ndërtimit që janë të listuara në Aneksin II të Direktivës: puna e ndërtimit për spitalet; objektet e dedikuara për sport, rekreacion dhe argëtim; objektet shkollore dhe universitare; dhe ndërtesa që përdoren për qëllime administrative. Në rast se autoritetet kontraktore që japin subvencionet nuk japin vetë kontrata të subvencionuara, ose ku ato e japin këtë kontratë për dhe në emër të subjekteve të tjera, atëherë ato duhet të sigurojnë përputhshmërinë me Direktivën gjatë procesit të dhënies së kontratës.

**Konkurset e projektimit:** Direktiva përmban gjithashtu rregulla të veçanta të përgjithshme që zbatohen për konkurset e projektimit. Konkursset e projektimit i referohen procedurave që u mundësojnë autoriteteve kontraktor që të marrin një plan ose projekt, i cili duhet të zgjidhet nga një juri e pavarur pasi të jetë paraqitur për konkurrim, me ose pa dhënien e çmimeve. Konkursset e projektimit organizohen kryesisht, por jo vetëm, në fushën e planifikimit urban të qytetit dhe të zonave rurale, arkitekturës, inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave.

### Pyetje e bërë shpesh 1:

**Çfarë është një kontratë PPP-je? Akronimi PPP i referohet "partneritetit publik privat". Nuk ka ndonjë përkufizim të vetëm ose të thjeshtë të kontratës PPP, pasi termi mbulon një gamë të**

llojeve të ndryshme të kontratave dhe modeleve të tjera të furnizimit të produkteve. PPP-ja në përgjithësi përfshin një marrëveshje sipas të cilës autoriteti kontraktor (sektori publik) hyn në një marrëveshje me një organizatë të sektorit privat për të ofruar infrastrukturën apo shërbimet publike. Struktura mund të jetë kontraktuale apo institucionale, ku kjo e fundit përfshin ngritjen e një ndërmarrje të përbashkët ose të një organizimi tjetër të ndërmarrjes së përbashkët, në të cilën autoriteti kontraktor dhe pala e sektorit privat marrin pjesë për të ofruar infrastrukturën ose shërbimet.

Një tipar themelor i PPP-së ka tendencë të jetë ndarja ose transferimi i rrezikut tek pala e sektorit privat, dhe PPP-të janë shpesh, por jo gjithmonë, me afat të gjatë. Metodatat e pagesës dhe të financimit ndryshojnë në bazë të PPP-së. Pagesat mund të bëhen nga autoriteti kontraktor ose mund të vijnë nga palët e treta, siç janë përdoruesit e objekteve, ose mund të vijnë nga një kombinim i burimeve. Financimi mund të vijë nga autoriteti kontraktor, pala e sektorit privat, apo nga financues të jashtëm, të tillë si bankat apo një kombinim i burimeve.

Shumë kontrata PPP-je do të jenë subjekt i zbatimit të plotë të Direktivës, por disa mund të jenë subjekt i Direktivës Koncesioneve. Shih Pyetjen e bërë shpesh 2 për komentet mbi kontratat e koncesionit.

### **Pyetje e bërë shpesh 2:**

**Çfarë është një koncesion? A mbulohet nga Direktivat?** Koncesioni është një kontratë e të njëjtit lloj si kontratat e përcaktuara në Direktiva, përveç se shpërblimi i punëve apo shërbimeve që do të realizohen, për shembull, përbëhet ose vetëm nga e drejta për të shfrytëzuar punën apo shërbimin ose nga kjo drejtë së bashku me pagesën.

Që një marrëveshje të klasifikohet si një koncesion duhet që koncesionari të pranojë rrezikun operativ gjatë shfrytëzimit të këtyre punëve ose shërbimeve në këmbim të mundësisë për të nxjerrë fitim përmes shfrytëzimit të "shërbimeve". Koncesionet ndonjëherë mund të klasifikohet si një formë e PPP-së.

Koncesionet përdoren, për shembull, për të realizuar dhe për të financuar projekte të mëdha të infrastrukturës, sidomos në lidhje me ndërtimin e rrjetit rrugor, ndërtimin e urave ose tuneleve, ku koncesionari shpërblehet me anë të tarifave të vëna për përdoruesit. Megjithatë, ato përdoren edhe thjesht për të siguruar operimin dhe mirëmbajtjen (në vend të ndërtimit) të objekteve nga koncesionarët, të tillë si në rastet kur një operatori i është dhënë me koncesion që të operojë një hekurudhën ekzistuese ose infrastrukturën hekurudhore nëntokësore. Llojet e mëparshme të koncesionit janë shembuj të koncesioneve të punëve; kjo e fundit është një shembull i një koncesioni të shërbimeve.

Koncesionet e punëve publike dhe koncesionet e shërbimeve janë trajtuar gjerësisht në Direktivën Koncesioneve.

Për më shumë informacion, shih:

Udhëzimin nr. 18 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Koncesionet dhe PPP-të*.

Udhëzimi nr. 32 i SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Direktivat 2014 të BE-së: Koncesionet*

### **Përfundimet**

Edhe kur kontratat klasifikohen nën përkufizimin e përgjithshëm të një kontrate publike, disa nga këto kontrata do të përjashtohen nga objekti i Direktivave për një numër arsyesh. Disa kontrata përjashtohen për shkak se ato nuk janë, nga natyra e tyre, të përshtatshme për konkurrencën. Disa nga përjashtimet zbatohen vetëm për kontratat e një lloji të veçantë. Disa kontrata përjashtohen sepse qeveritë dëshirojnë t'i përjashtojnë ato nga konkurrenca për arsye të caktuara. Ekziston edhe një kategori e kontratave të "rezervuara" që, edhe pse nuk përjashtohet, nuk përfitojnë nga trajtimi preferencial.

## Përrjashtimet për shkak të natyrës së kontratës

**Kontratat e blerjes së tokës:** Direktivat përjashtojnë kontratat për blerjen ose marrjen me qira, me çfarëdo mjeti financiar, të tokës, ndërtesave ekzistuese apo pronave tjera të paluajtshme, ose për blerjen e të drejtave mbi to. Këto kontrata janë përjashtuar për shkak se ato kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme, e cila është natyrisht e varur nga pozita gjeografike. Kontrata të tilla ndodhin kryesisht në tregjet lokale, dhe objektet e tyre në përgjithësi përjashtojnë çdo mundësi reale për konkurrencë ndërkuftare.

Është e rëndësishme të theksohet se marrëveshjet e zhvillimit dhe llojet e tjera të marrëveshjeve të pronës mund të mos klasifikohen domosdoshmërisht nën këtë përjashtim, kryesisht për shkak se një kontratë pune jepet si pjesë e marrëveshjes së përgjithshme.

**Përrjashtimet që lidhen në mënyrë specifike me shërbimet:** Këto përjashtime zbatohen për rrethana specifike, që bazohen ose në dhënien e të drejtave ekskluzive për autoritetet e caktuara për të kryer shërbime të caktuara ose në natyrën e një numri shërbimesh të përcaktuara, si më poshtë:

- Kontratat e shërbimeve të dhëna në bazë të të drejtave ekskluzive;
- Materialet dhe koha e transmetimit;
- Shërbimet e arbitrazhit dhe të pajtimit;
- Shërbimet e caktuara juridike;
- Shërbimet e caktuara financiare;
- Kreditë;
- Shërbimet kërkimore dhe të zhvillimit të ndryshme nga ato që shpërblehen tërësisht nga autoriteti kontraktor, ku përfitimet i përkasin ekskluzivisht autoritetit kontraktor për përdorimin e tij në funksion të kryerjes së punëve të veta;
- Kontratat e punës;
- Shërbimet e mbrojtjes civile, shërbimet e mbështetje civile dhe të parandalimit të rrezikut;
- Disa kontrata studimi dhe zhvillimi;
- Shërbimet e fushatës politike të dhëna nga partitë politike në kuadër të fushatës zgjedhore;
- Shërbimet e komunikimit elektronik;
- Shërbimet e transportit të udhëtarëve publik me hekurudhë ose metro.

## Përrjashtimet për arsye të zgjedhjes

Këto përjashtime kanë të bëjnë me prokurimin e një natyre ushtarake, që është prokurimi i cili kërkon sekret, dhe prokurimit që, me marrëveshje, është subjekt i rregullave të ndryshme të prokurimit. Të tre llojet e përjashtimit kanë të bëjnë me Direktivën.

**Prokurimi i mbrojtjes:** disa kontrata të dhëna në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë mbulohen ose nga Direktiva e Mbrojtjes<sup>7</sup> ose përjashtohen nga Direktiva e Mbrojtjes në bazë të një dispozite të veçantë në Direktivën e Mbrojtjes.

---

<sup>7</sup> Direktiva 2009/81/KE mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të caktuara punëve, kontratave të furnizimit dhe kontratave të shërbimit nga autoritetet apo subjektet kontraktore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe ndryshimin e Direktivave 2004/17/KE dhe 2004/18/KE, 13 Korrik 2009.



**Kontratat që kërkojnë masa sekrete:** Direktivat nuk zbatohen për kontratat publike: 1) që janë deklaruar sekrete; ose 2) realizimi i të cilave duhet të shoqërohet me masa të veçanta sigurie, në përputhje me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative në fuqi në Shtetin Anëtar në fjalë; ose 3) kur mbrojtja e interesave thelbësore të sigurisë së shtetit nuk mund të garantohet me masa më pak ndërhyrëse, për shembull duke imponuar kërkesa që kanë për qëllim mbrojtjen e natyrës konfidenciale të informacionit që është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor.

**Kontratat që rregullohen nga rregulla të tjera:** Direktivat nuk zbatohen për kontratat që rregullohen nga rregulla të ndryshme procedurale dhe që janë dhënë:

- Në bazë të një instrumenti ligjor që krijon detyrime ndërkombëtare, të tilla si një marrëveshje ndërkombëtare, e lidhur në përputhje me Traktatin, ndërmjet një Shteti Anëtar dhe një ose më shumë vendeve të treta apo të nënndarjeve të tyre dhe që mbulojnë punët, furnizimet ose shërbimet me qëllim zbatimin e përbashkët apo shfrytëzimit të një projekti nga palët nënshkruese të tyre;
- Sipas procedurës së veçantë të një organizate ndërkombëtare, të tillë si Kombet e Bashkuara, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, apo Banka Botërore.

Po ashtu, Direktiva nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit që autoriteti kontraktore jep ose organizon në bazë të rregullave të prokurimit të ofruara nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, nëse këto kontrata dhe konkurse të projektimit janë financuar plotësisht nga ajo organizatë apo ai institucion. Në rastin e bashkë-financimit, kur fondet janë nxjerrë kryesisht nga një organizatë apo instrument ndërkombëtar, palët në marrëveshje duhet të bien dakord mbi procedurat e zbatueshme të prokurimit.

### Prokurimi i brendshëm

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJED) ka zhvilluar jurisprudencën e saj gjatë viteve lidhur me kushtet në të cilat autoritetet kontraktore mund t'i japin kontrata personave të tjerë juridikë direkt, pa ndjekur proceset e prokurimeve publike. Kushtet në bazë të së cilave do të ishte e mundur për ta bërë këtë janë shpjeguar në jurisprudencën e gjerë gjyqësore të GJED-së dhe të konsoliduar në formën e dispozitave të Direktivave të vitit 2004, me titull "Kontratat publike ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik".

Për më shumë diskutim mbi këtë përjashtim, shih Udhëzimin nr. 39 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Prokurimi i brendshëm*.

### Kontratat e rezervuara

Direktivat parashikojnë një kategori kontratash të "rezervuara", të cilat nuk janë të përjashtuara nga objekti i Direktivës, por janë subjekt i imponimit të kushteve specifike të kualifikimit të pjesëmarrësve. Shtetet anëtare të BE-së mund të rezervojë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat për dhënien e kontratave publike që kanë të bëjnë me qendrat e punës të operatorëve ekonomik, qëllimi kryesor i të cilave është integrimi social dhe profesional i personave me aftësi të kufizuara dhe të pafavorizuar ose ato mund të parashikojnë kontrata të tilla që duhet të zbatohen në kuadër të programeve të mbrojtura të punësimit, ku të paktën 30% e punonjësve të këtyre qendrave të punës, të operatorëve ekonomik ose të programeve janë punëtorë me aftësi të kufizuara apo të pafavorizuar.

Direktivat kanë futur një kategori të re të kontratave të rezervuara për shërbime të caktuara.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore mund të rezervojë të drejtën që organizatat të marrin pjesë në procedurat për dhënien e kontratave publike vetëm për shërbimet shëndetësore, sociale dhe kulturore që janë të listuara sipas referencës së kodeve të FPP-së në nenin 77 të Direktivës.

Kohëzgjatja e kontratave të rezervuara nuk mund të jetë më shumë se tre vjet.

Organizatave që kualifikohen për të marrë pjesë në procedurën e kontratës së rezervuar duhet të përmbushin të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Objektivi i tyre duhet të jetë ndjekja e një misioni të shërbimit publik të lidhur me ofrimin e shërbimeve të përmendura më lart.
- Fitimet duhet të ri-investohen me synimin për të arritur objektivin e organizatës; çdo shpërndarje ose ri-shpërndarje e fitimeve duhet të bazohet në vlerësime pjesëmarrëse.
- Strukturat e menaxhimit ose të pronësisë së organizatave që realizojnë kontratën duhet të bazohen në pronësinë e punonjësve ose në parimet e pjesëmarrjes, ose duhet të kërkojnë pjesëmarrjen aktive të punonjësve, të përdoruesve ose palëve të interesuara.
- Organizata nuk duhet të ketë marrë një kontratë për shërbimet përkatëse nga autoriteti kontraktor në fjalë në përputhje me këtë procedurë brenda tre viteve të fundit.

Për më shumë diskutime mbi kontratat e rezervuara, shih Udhëzimin nr. 14 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Përfshirja e Vlerësimeve Sociale në Prokurimin Publik*.

## Shërbimet

### Përfshirjet specifike për sektorin e shërbimeve

Direktiva e Shërbimeve parashikon përfshirje specifike sektoriale në një numër sektorësh të shërbimeve, bazuar kryesisht në shkallën e konkurrencës në këto tregje. Shembuj të këtyre përfshirjeve përfshijnë kontratat për blerjen e karburantit për prodhimin e energjisë dhe kontratat për blerjen e ujit.

Direktiva e Shërbimeve gjithashtu përmban një mekanizëm të përgjithshëm të përfshirimit për aktivitetet e ekspozuara ndaj konkurrencës në tregjet, në të cilat aksesimi nuk është i kufizuar.

Direktiva e Shërbimeve gjithashtu përmban një sërë përfshirjesh të tjera specifike për sektorin e shërbimeve, duke përfshirë:

- **Aktivitetet jashtë Bashkimit Evropian:** Direktiva e Shërbimeve nuk zbatohet për kontratat e dhëna nga subjektet kontraktore për qëllime që janë të ndryshme nga ndjekja e aktiviteteve të tyre përkatëse, ose ushtrimi i aktiviteteve të tilla në një vend të tretë, në bazë të kushteve që nuk përfshijnë përdorimin fizik të një rrjeti ose zone gjeografike brenda Bashkimit Evropian.
- **Përfshirja për filialet:** Kur "ndërmarrja" përbëhet nga një numër shoqëri në pronësi reciproke apo reciprokisht të varur, atëherë Direktiva e Shërbimeve parashikon një përfshirje të veçantë për blerjet e bëra ndërmjet kompanive të tilla, duke iu nënshtruar kushteve të caktuara. Këto blerje trajtohen si kontrata "të brendshme", të njohura si transaksione brenda grupit. Kontratave të përfshiruara, në varësi të plotësisht të kushteve të caktuara, janë ato të cilat janë dhënë për filialet, qëllimi kryesor i të cilave është që të veprojnë si ofrues të shërbimeve qendrore për grupin të cilit ato i përkasin në vend që të shesin shërbimet e tyre në mënyrë tregtare në tregun e hapur.

**Blerjet për ri-shitje ose qira:** Direktiva e Shërbimeve përjashton nga objekti i zbatimit të saj të gjitha kontratat që i janë dhënë palëve të treta për qëllime ri-shitjeje ose qiraje. Ky përfshirje ka për qëllim që të përfshijë kontratat për mallrat, ku subjekti kontraktor synon të shesë ose të fusë në punë pajisjet e blera në një treg konkurrues. Këto kontrata do të përjashtohen vetëm nëse subjekti kontraktor nuk gëzon asnjë të drejtë të veçantë ose ekskluzive për të shitur apo të futur në punë subjektin e kontratave të tilla dhe nëse subjektet e tjera janë të lira për të shitur apo të futur në punë të njëjtat mallra në të njëjtat kushte si subjekti kontraktor.

## Informacion i mëtejshëm

### Botimet e SIGMA-s

*Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik– Modulet D3 dhe D4*

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

### Udhëzimet e SIGMA-s për Prokurimin Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

Udhëzimi për Prokurimin Publik 5, *Të kuptuarit e kufijve monetarë të BE-së*

Udhëzimi për Prokurimin Publik 14, *Përfshirja e Vlerësimeve Sociale në Prokurimin Publik*

Udhëzimi për Prokurimin Publik 16, *Prokurimi nga Shërbimet*

Udhëzimi për Prokurimin Publik 18, *Koncesionet dhe PPP-të*

Udhëzimi për Prokurimin Publik 23, *Prokurimi i mbrojtjes*

Udhëzimi për Prokurimin Publik 30, *Direktivat 2014 të BE-së: Prokurimi i Sektori Publik dhe i Shërbimeve*

Udhëzimi për Prokurimin Publik 31, *Direktivat 2014 të BE-së: Koncesionet*

Udhëzimi për Prokurimin Publik 39, - *Prokurimi i brendshëm*

SIGMA (2014), *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik (2006-2014)*, Botimet e OECD-së, Paris

<http://www.sigmaweb.org/publications/Judgements-CourtJustice-31July2014-Alb.pdf>

### Jurisprudenca

Jurisprudencë e zgjedhur e GJED-së: C-107/98 **Teckal**, C-399/98 *Ordine degli Architetti dhe të tjerët*, C-26/03 *Stadt Halle dhe RPL Lochau*, C-220/05 *Auroux dhe të tjerët*, C-451/08 *Helmut Müller*, C-337 / 05 *Komisioni kundër Italisë*, C-157/06 *Komisioni kundër Italisë*, C-382/05 *Komisioni kundër Italisë*, C-226/09 *Komisioni kundër Irlandës*, C-197/11 *Libert dhe të tjerët*

[http://curia.europa.eu/jcms/jcms/j\\_6/](http://curia.europa.eu/jcms/jcms/j_6/)